

VENDIM
Nr.698, datë 16.7.2008

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TV SHIJAK”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privat rtv” dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV Shijak”, për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)